

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data 13.02.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM I PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË JASHTME NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA, TIRANË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) **90910000-9**.

VLERA E FONDIT LIMIT: **38,247,344.10** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e dyzet e katër pikë dhjetë) **lekë, pa TVSH ose 396,551** (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 13.02.2026 (96.45 lekë/euro).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i

ndryshuar), duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë këtë dokument ligjor të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), pasi është e domosdoshme për subjektet që angazhohen në aktivitete që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe që kërkojnë një monitorim dhe menaxhim të kujdesshëm të mbetjeve.

Leja mjedisore e kërkuar gjykohet e nevojshme duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit që është transportimi i mbetjeve deri në Landfill, për tu siguruar që grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve do të kryhen në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për të parandaluar ndotje dhe dëme mjedisore, në përputhje me nenit 57 të ligjit 10463, 2011 (i ndryshuar)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë shërbimi / apo çdo dokument tjetër me një landfill për depozitimin e mbetjeve për periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të disponojnë një dokument me një landfill për depozitimin e mbetjeve për periudhën e zbatimit të kontratës. Kjo kërkesë vendoset për të siguruar se operatori do të kryejë evadimin e mbetjeve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve (Ligji nr. 10463/2011), i ndryshuar, duke garantuar që mbetjet urbane nuk do të përbëjnë rrezik për shëndetin publik apo mjedisin. Dokumenti me landfillin duhet të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të jetë me një subjekt të licencuar për trajtimin apo depozitimin e mbetjeve. Kjo shërben për të siguruar që operatori ekonomik disponon kapacitete mjedisore dhe logjistike për trajtimin e mbetjeve, duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin publik.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme, e cila përfshin objektin e prokurimit), si më poshtë si më poshtë:

- SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH EN ISO 45001 “Sisteme të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke qenë se objekti i procedurës së prokurimit lidhet me shërbimin e pastrimit për spitalin si evadimi i mbetjeve, i cili është një shërbim i ndjeshëm dhe ka ndikim të drejtëpërdrejtë në shëndetin e pacientëve dhe stafit mjekësor, vlerësohet e rëndësishme që ofertuesi të jetë i certifikuar me standartet e kërkuara në këtë kriter, për arsye si më poshtë:

Standarti 14001 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standard është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekti i prokurimit është pastrimi i ambjentëve të jashtë të QSUT dhe transportimi i mbetjeve urbane deri në landfill. Pasi me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis. Plotësimi i këtij standarti është një garanci që ofertuesi do të menaxhojë në mënyrë të sigurtë mbetjet dhe produktet kimike të pastrimit, elementë këta shumë të rëndësishëm për objektin e prokurimit, pasi përdorimi i kimikateve të papërshtatshme mund të dëmtojë jo vetëm mjedisin, por çënon drejtëpërdrejtë edhe jetën e shëndetin e pacientëve dhe stafit mjekësor.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron se operatori ekonomik ka një sistem të strukturuar menaxhimi për cilësinë e vazhdueshme të shërbimit objekti prokurimi. Plotësimi i këtij standarti siguron ekzistencën e procedurave dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e cilësisë së shërbimit, e cila në një ambient spitalor është thelbësore, pasi devijimet në cilësi mund të rrezikojnë higijenën dhe sigurinë e pacientëve.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Është një tregues që operatori mbron punonjësit nga rreziqet, kimike dhe fizike që lidhen me pastrimin e ambjentëve të jashtë të QSUT dhe

evadimin e mbetjeve deri ne landfill, si dhe siguron trajnime, pajisje mbrojtëse, protokolle sigurie dhe masa prandaluese për aksidente që mund të ndodhin gjatë realizimit të shërbimeve.

2.3.5 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit te pastrimit objekt prokurimi për territorin e QSUT, duhet të kenë të punësuar minimumi 21 punonjës, si më poshtë:

- 2 punonjës Përgjegjës shërbimi / per 2 turne
- 3 punonjës shofer
- 6 punonjës shërbimi turni i parë
- 6 punonjës shërbimi turni i dytë
- 2 punonjës ndihmës për evadimin e mbetjeve turni i parë
- 2 punonjës ndihmës për evadimin e mbetjeve turni dytë

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjës të Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi /Ekspert Mjedisi dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi / Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit e shërbimit/ pastrimi

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

c. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje drejtimi (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi do të realizohet në kohë dhe sipas nevojave të përshkruara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Për Përgjegjës të Shërbimit:

- Përgjegjësit e shërbimit duhet të jenë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi:

Lidhur me kriterin për 2 përgjegjës të shërbimit (cdo turn do të ketë 1 përgjegjës shërbimi) është gjykuar e nevojshme se duhet të jenë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit i cili përfshin aspekte të pastrimit dhe infrastrukturës përreth si dhe

transportimin e mbetjeve urbane në Landfill, pasi inxhinier mjedisit/ekspert mjedisi mbikqyr aspektet teknike dhe mjedisore të shërbimit. Detyrat e përgjegjës të shërbimit janë monitorimi dhe sigurimi që proceset e punës të jenë në përputhje me legjislacionin mjedisor. Gjithashtu inxhinieri i mjedisit mbikqyr praktikën e sigurisë në punë, duke siguruar që procedurat e pastrimit të mos shkaktojnë ndotje të ajrit, ujit apo dhe ndikime të tjera negative në mjedis. Gjithashtu mund të ndihmojë në zbatimin e protokolleve të sigurisë për punonjësit.

punonjësit shofer – duke qenë se për kryerjen e proceseve të punës janë kërkuar 1 autobot uji për larjen e rrugëve si dhe 2 mjete teknologjike transportuese të mbetjeve urbane, është e domosdoshme dhe kërkesa për 3 shofer për drejtimin e mjeteve të sipërpërmendur.

Punonjësit e pastrimit janë të nevojshme për kryerjen e pastrimit, në ambientet e jashtme, sipas specifikimeve teknike, grafikut të realizimit, termave të referencës të vendosura nga AK.

Punonjësit ndihmës për Evadimit të mbetjeve; janë përgjegjës për mbedhjen e mbetjeve të përditshme nga koshat në zonat e caktuara si dhe pastrimin e tyre pas përfundimit të grumbullimit. Një detyrë tjetër përfshin dhe ngarkimin e mbeturinave në mjetin transportues dhe sigurimin e tyre që të mbahen të mbyllura dhe të mos shkaktojnë ndotje gjatë transportit.

2.3.6 Operatori ekonomik, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) autobot uji me kapacitet jo më të vogël se 7000-8000 litra
- 1 (nje) pompe me presion/ tub uji të lidhur me cisterne/ makine për trotuare apo kende të vështira
- 2 (dy) mjete teknologjike transportuese të mbetjeve urbane, me kapacitet minimal 5 ton, të mbyllur, të pajisur me mekanizëm ngritës fundor, me ndriçim fundor dhe sinjalizues zanor

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet e pajisjet e nevojshme për përmbushjen e kontratës e cila lidhet ngushtësisht me të gjitha proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi. Mjetet teknologjike janë gjykuar të domosdoshme për transportimin e mbetjeve urbane në mënyrë të sigurt të shpejtë dhe efektive pas shkaktoar ndotje apo probleme të tjera gjatë procesit. Evadimi imbetjeve me këto mjete është mjaft i rëndësishëm pasi akumulimi i tyre do të përbente burim për vatra infeksionesh dhe ndikim më gjerë në mjedis.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të disponojë:

- 1 (një) peshore e kolauduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë me kapacitet jo me pak se 3 t.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Kriteri për peshoren e kolauduar nga drejtoria e metrologjisë bazohet në Ligjin Nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, i cili siguron AK që çdo mjet matës që do të përdoret duhet të jetë i kolauduar dhe i certifikuar nga autoriteti kompetent – Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë si dhe Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka për qëllim të sigurojë saktësinë e matjes së sasisë së mbetjeve që trajtohen, transportohen apo depozitohen, gjurmueshmërinë dhe transparencën duke u kërkuar që operatorët ekonomike të raportojnë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, trajtuara ose depozituara.

2.3.8 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve për pastrimin e segmenteve rrugore dhe prerjen e barishteve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë si dhe me materiale pastrimi si fshesë dore profesionale, thasë plastikë, gërsërë prerese barishtesh, karrocë transporti, lopatë si dhe shishe me solucion dezinfektuese për zona me ndotje organike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6 e nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të sigurojnë shërbimin e dizefektimit të koshave dhe ambientit të vendgrumbullimit të mbetjeve urbane është një masë e domosdoshme higjieno-sanitare kjo Kerkese eshte vendosur referuar Ligji nr.10431, datë 9.6.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për inspektimin shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik”. kjo kerkese siguron Ak qe operatori ekonomik duke kryer kete shrbim siguron uljen e rrezikut te infeksioneve tek punonjësit dhe komuniteti si dhe kontrolli i erërave te pakëndshme dhe ndotjen mikrobiale të ajrit dhe ujërave përreth. Eshte e rendesishme për parandalimin e rreziqeve biologjike dhe shëndetësore apo përhapjes së mikroorganizmave patogjenë, që vijnë nga mbetjet organike dhe inorganike, gjithashtu për neutralizimin e erërave të forta që lëshojnë mbetjet në temperaturat e larta.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza QSUT, Tiranë, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 *“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”*, i ndryshuar.